



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 03.08.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Rita Zeqiri (VV), Gresa Lahu (PDK), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

Të pranishëm ishin edhe: Arta Balaj, drejtore në Drejtorinë e Kulturës, dhe Granit Rugova, drejtor në Drejtorinë e Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Valbona Ajeti, kryesuese e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për mbledhje propozoi këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Informatë nga Arta Balaj, drejtore në Drejtorinë e Kulturës;
3. Informatë nga Granit Rugova, drejtor në Drejtorinë e Sportit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Faqelnga4

Pika e dytë

Informatë nga Arta Balaj, drejtoreshë në Drejtorinë e Kulturës.

Arta Balaj, drejtoreshë e përhëndetive të pranishmit dhe i njoftoi rreth punëve të kryera gjatë këtyre muajve nga Drejtoreshia e Kulturës, nga marrja e detyrës si drejtoreshë. Ajo fillimisht ceku disa aktivitete të cilat janë organizuar dhe janë mbajtur gjatë kësaj kohe siç janë: 1 qershori, Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 11 qershori, Dita e çlirimit të Prishtinës, 21 qershori, Dita ndërkombëtare e muzikës "Manifesta", koncerti i filharmonisë së Kosovës, koncerti i Ramë Lahajt dhe shumë organizime të ndryshme.

Sa i përket shpalljes së subvencioneve për kulturë, shpallja është bërë tani dhe për këtë është formuar një komision i përbërë për çdo kategori të përzgjedhur të fushës, ku një zyrtar është nga Drejtoreshia e Financave, një nga Drejtoreshia e Kulturës, një nga njësit bartëse ose bibliotekave, dhe një nga Teatri Dodona, kështu janë përfunduar dhe vlerësuar të gjitha raportet dhe i kemi shpallur fituesit.

Vlenë të theksojmë se kanë përfunduar edhe disa aktivitete të prokurimit, është inicuar dhe kryer ndarja e një shumë të mjeteve për renovimin e Amfiteatrit të qytetit aty afër Grand Hotelit dhe është nënshkruar kontrata dhe mbetet vetëm të fillojë puna.

Mandej janë disa projekte, si renovimi i qendrës kulturore në Llukar, konkursin e projektimit të "Kurritzit", furnizimi me libra që bëhet për gjdo vitë, përzgjedhja e kompanisë e cila do të kryej dekorimin e qytetit, renovimi i Sahat kullës etj.

Po ashtu jemi në përfundim të një marrëveshje me Swiss kontaktin, për pjesën e ueb-it In-Prishtina. Për shkak të përditsimit të dhënave dhe po mundohemi ta kthejmë në pronë të Drejtorisë së Kulturës, dhe aty t'i kryejm shpalljet për aktivitete të ndryshme kulturore.

Pjesë e kësaj marrëveshje është edhe Parku i aventuarve, ku tashmë është ndarë një pjesë e tokës të Parku i arinjëve, kemi filluar diskutimet me Ministrinë e Kulturës dhe IKMM-në, për vazhdimin e punëve në rrugën model, e cila ka mbetur në gjendje mjaftë të keqe.

Gjithashtu mendojmë se kemi edhe shumë gjëra tjera si, mungesa e publikimeve informative të objekteve të trashëgimisë kulturore, një kalendar i përbashkët me Ministrinë e Kulturës etj.

Rita Zeqiri, tha se ne duhet të kemi strategjinë tonë si Komunë, por normal të jetë e ndërlidhur dhe të kemi edhe përfaqësues nga komiteti, federatat dhe nga Ministria, por para së gjithash duhet të kemi përfaqësues të cilët e njohin gjendjen faktike në teren. Sa i përket ankesave në subvencione ajo tha se nuk duhet të merren gjithmonë si diçka negative, prandaj ne kemi nevojë t'i ndryshojmë edhe rregulloret, edhe t'i shohim prioritetet në subvencionim.

Me 440 mijë euro në këto nivele nuk mundemi t'i mbulojmë, por mendojmë se ndoshta më mirë është të ndihmohen klubet se sa federatat, sepse ato kanë një linjë buxhetore. Për kulturën në Prishtinë, besoj se shumë evente sportive të cilat do të mundemi me i bërë do të ishte shumë e mirë që të kemi një ndërlidhje të përbashkët kulturore.

Arta Balaj, drejtoresha tha se për këtë vit e kemi pas një buxhet të propozuar dhe miratuar nga dikush tjetër, por besoj se nga tash duhet të përgatitemi për vitin e ardhshëm, të planifikojmë buxhetin.

Valbona Ajeti, kryesuesja tha se ne si komitet do të ishte mirë që ta kemi një plan të punës, kështu edhe ne do të mundemi të përgatitemi dhe të ju ndihmojmë edhe më shumë rreth aktiviteteve të ndryshme nga drejtorja e juaja.

Arta Balaj, drejtoresha po ashtu informoi rreth renovimit që është bërë në shkollën "Elena Gjika".

Granit Rugova, drejtor përsëhendeti të pranishmit duke i njoftuar me punët dhe aktivitetet që Drejtorja e Sportit ka kryer gjatë kësaj kohe siç janë: Laureatët e vitit 2021, 3x3 Fiba Challenger, kupa botërore në hendboll, 2 aktivitete të futbollit të vogël dhe shumë aktivitete të tjera të cilat janë përkrahur nga drejtorja.

Këndi i lojërave dhe fitneseve, është një projekt i cili veç se ka përfunduar, po ashtu i kemi përfunduar 3 fusha sportive atë në Bardhosh, Llukar, Grashicë dhe ajo në Emshir dhe në Kodrën e Trimave janë në përfundim e sipër.

Jemi në përfundim e sipër në rregullimin e shtegut të vrapimit në Arbëri, po ashtu në renovimin e tribunave të stadiumit "2 korriku", një mini golf ku jemi në hulumtim të një lokacioni të mundshëm.

Fusha në Prugoc, është e përfunduar por problemi aty qëndron të lumi Llap, një fushë tjetër mbrapa Terranovës, këtu në qendër, por aty kemi probleme për shkak të mospranimit nga banorët dhe kështu jemi duke e rishikuar së ku mundë ta zhvendosim.

Salla multifunkionale do të jetë të kampusi në Bërnice, e cila do t'i ketë 5000 ulëse. Faza e parë e subvencioneve në sport 90% të pagesave vetëm se janë kryer në fund të javës besojë e hapim thirrjen për ndarjen e bursave për "Shpresat" e sportit, ku do të ndahen 20 bursa me nga 1000 euro.

Tash pas bartjes së buxhetit, e kemi ndarë një parcelë dhe i kemi ndarë 300 mijë euro për stadiumin, për tri klube futbollit në Hajvali, për klubin futbollistik "Flamurtari", si dhe disa projekte të tjera si atë të fitnesit në Gërmi apo Dardani, riparimin e dy fushave në Kodrën e Trimave, hapjen e shtigjeve për ecje dhe biçikleta, renovimin e parketit të sallës së vogël në Pallatin e rinisë, etj.

Endrit Zabërgja, përsëhendeti drejtorët dhe i falenderojë për informatat e dhëna, ai ngriti probleme dhe shqetësime rreth projekteve që Komuna e Prishtinës, duhet të bëjë për të rinjët. Lidhur më këtë tha se dua të di së çfarë roli apo funksioni kryen Sektori për Rininë në Komunën e Prishtinës.

Granit Rugova, drejtor tha se një zyrtar në Drejtorinë e Sportit është që merret me rininë, tash janë ndërmarrë disa hapa të tjerë në këtë drejtim dhe në krijimin e një plani strategjik për rininë.

Gresa Lahu, tha se ne të rinjët të cilët jemi edhe anëtarë të Kuvendit, në bashkëpunim edhe me drejtorët e drejtorive përkatëse mundë edhe të krijojmë një plan për të rinjët në Komunën tonë.

Endrit Zabërgja, tha se në kuadër të plan programit gjatë fushatës së kaluar ne e kemi pasur si pikë, ku qytetarët e Prishtinës përmes një platforme online të kishin mundësi të zgjidhnin vetë një aktivitet i cili mandej do të hynte në kalendarin e planifikimeve dhe unë jam i gatshëm të japë maksimumin rreth projekteve që kanë të bëjnë më rininë e qytetit tonë.

Adelina Mehiu, tha se për pjesën e ndërtimit të "Kurrizi", do të ishte mirë që të merret edhe mendimi i qytetarëve.

Arta Balaj, drejtore tha se do të shohim mundësin e inkuadrimin dhe mendimet e qytetarëve në atë projekt.

Valbona Ajeti, kryesuese tha se do të presim ndihmë nga ju, në mënyrë që të krijojmë edhe planin e punës si komitet dhe në mbledhjet e radhës të vazhdojmë në bazë të atij plani.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesuesja e mbledhjes së Komitetit
Valbona Ajeti



Faqe4nga4